



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 33, date 20.05.2019

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E BARDHYL TOKA, BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 20.05.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Bardhyl Toka** (4 anëtarë familje) në vlerën prej **80.000 lekë** (*tetëdhjetë mijë*), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Burimi i financimit është fondi i emergjencave civile në programin P03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2019, në programin P03280, O1 A2 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 80,000 lekë.
3. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen z. Bardhyl Toka.

4. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën **640,998 lekë** (*gjashtëqind e dyzet mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë*) sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Bardhyl Toka**.
5. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e Bardhyl Toka, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
6. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 80,000 lekë (*tetëdhjetë mijë*).
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 20.05.2019

Shpallur në datën 21.05.2019

**Sekretar i këshillit**



**Suel Hadri**

**KRYETAR**



**Xhemal BUSHATI**

